

20232364114

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SHËNDETËSORE

### Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21, 122/21, 178/21, 150/22 dhe 236/22), në nenin 231, paragrafi (10), fjalët: "dhënia e licencës lidh marrëveshje për licencë" zëvendësohen me fjalët: “kryerja e veprimtarisë në rrjetin e institucioneve shëndetësore lëshon aktvendim për kryerjen e veprimtarisë në rrjetin me të cilin jepet licenca”.

Pas paragrafit (16) shtohet paragrafi i ri (17) si më poshtë:

“(17) Me përjashtim të paragrafit (11) të këtij neni, nëse jepet licenca për shfrytëzimin e hapësirës apo pajisjeve të institucionit publik shëndetësor institucionit shëndetësor i cili duhet të pushojë me punë në përputhje me nenin 318 të këtij ligji, kurse në institucion punon edhe një ekip i dytë, bartësi i veprimtarisë është me stazh pune prej të paktën një vit në institucion, institucioni publik shëndetësor nuk zbaton procedurë për dhënien me qira të hapësirës apo pajisjeve, kurse hapësira dhe pajisja e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë përkatëse i ndahet bartësit të veprimtarisë nga ekipi i dytë i punësuar në institucionin shëndetësor, në bazë të vendimit të këshillit drejtues të institucionit publik shëndetësor dhe pëlqim me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë, që do t'i përgjigjen kërkesës të paktën tre muaj përpara se koncesionari aktual të pushojë me punë, në përputhje me nenin 318 të këtij ligji.”.

### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.